

Konvergjenca e identitetit

*Ibrahim Berisha**

Përmbledhje

Në trajtimin e temës së identitetit shqiptar zotëroi qasja publicistike. Kjo qasje mbajti identitetin në një gjendje status quo-je, duke sforcuar standardin tradicional kulturor dhe social. Koncepti interpretues romantik, folklorik i kombit, provoi të interpretojë krizën e identitetit si humbje e vlerave tradicionale, siç janë familja, fisi, provincialiteti, të folmet rajonale etj., dhe jo si proces i rritjes së konvergimit, tjetërsimit, rezignimit etj. Nuk respektohet në shkallën reale se identiteti nacional është kategori juridiko-politike dhe në anën tjetër edhe i lidhur ngushtë me ekzistimin e bashkësisë kulturore. Identiteti nacional shprehet përmes institucioneve të përbashkëta, detyrave dhe përgjegjësisë të të gjithë anëtarëve të një grupi.

Në temë trajtohen edhe disa nga qasjet kryesore sociologjiko-politike të identitetit, duke pasur referencë identitetin e kombit amerikan.

Fjalët kyç: identitet, individual, kolektiv, grup etnik, sub-etnik, nacional, komb-shtet, nacionalpatriotizëm, neoshqiptarizëm, homogjenitet, diversitet, plural.

Gjatë gjithë shek. XX janë rritur divergjenca në temën e identitetit, edhe për identitetin shqiptar, veçmas në kontekstin e përkatësisë së tij - qytetërimit evropian, dhe vlerave të pranishme të kulturave të orientit (arabe-perse-osmane) që mbeten si pasojë e konvergimit dinamik të gjatë fizik dhe shpirtëror. Diskutimi publik vazhdon të bëhet po në kuptimin, të cilën e shpreh interpretimi dhe dilema universale: Identiteti, cili jam Unë, cili është Ai, cilët jemi Ne dhe cilët janë Ata?

* Prof. ass. dr. Ibrahim Berisha, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Sociologjisë, Universiteti i Prishtinës, Universiteti AAB, Republika e Kosovës, Iberisha5@hotmail.com

Megjithëse duket stereotipe kjo pyetje, Un-i, në këtë rast edhe shqiptar, nuk dallon nga të tjerët, është Ego, pra që ka domethënie të ngjashme sociale dhe kulturore edhe te kombet e tjera. Semiotikisht, shprehet Lotman, struktura "Unë" është një nga treguesit themelor të kulturës. "Unë" si përemër është shumë më i thjeshtë për nga struktura e tij, se sa "Unë" si emër i përveçëm. I fundit nuk paraqet në vetvete shenjë gjuhësore fort të përvijuar.¹

Nëse ky emër i përveçëm ndërlidhet me shenjën gjuhësore, atëherë fjala është për referencën e theksuar kulturore dhe sociale. Kështu, ende vazhdon të mbetet konteksti kulturor dhe social si interpretimi i rëndësishëm i fenomenit identitet, qasje kjo e theksuar edhe nga Agar. Këtu do t'i referohemi shpjegimit që i bënë ai identitetit amerikan, fenomen modern ky i identitetit nacional. Ai shprehet se - Unë - shpjegon atë që ndërlidh dallimet me një identitet: amerikan.² Njëra prej gjërave që e bën shpjegimin kulturor më të plotë është, pikërisht ai, se dallimi në mes të diçka-je që është X apo Y, ka të bëjë, me faktin se ky dallim është i ndërlidhur me identitete të ndryshme, të dhëna, pra si X dhe Y.³

Në qasjen e tij, Agar duket i ndikuar nga pikëpamja e Moses, i cili pohon konceptin e mahnitshëm të krijimit të kombit nga lumëza e mbetjeve "të qerratas" dhe të "hordhive" pa art, pa armë, pa talent, pa virtualitet e guxim, të atyre që vërtiteshin si një kolonë e të huajve nëpër rruzullin tokësor pa asnjë milimetër të themelit të tyre.⁴

Këta njerëz, sipas Moses, kanë guximin të krijojnë trupin politik, si njerëz të lirë, duke iu dhënë mundësia e ndërtimit të institucioneve dhe, po kështu, koha dëshmoi se kjo mrekulli dhe mundësi, nuk mund të shkatërrohet apo ndryshohet qe pesë mijë vjet.

¹ Jurij Lotman: *Kultura dhe bumi*, përktheu Agron Tufa, bot. elektr. f.21.

² Është e vlefshme të përkujtohet se identiteti amerikan u krijua mbi 200 vjet më parë duke bërë shkrirjen apo pranimin e shumë kulturave të ndryshme. Format i ri kulturor prodhoi meting-pot., indianë, austriakë.

³ Michel Agar: *Understanding the culture of conversation*, New York, 1993, f. 126.

⁴ Po aty, f. 99.

Në anën tjetër, ka edhe një të teori shumë të njohur për identitetin dhe ajo është teoria sociale e përfaqësuar nga Tajfel dhe Turnera. Thelbi i kësaj teorie mund të përmblihet në interpretimin se identiteti nacional i secilit njeri është i kushtëzuar nga identiteti social që mbështetet në faktin: po secili njeri u përket grupeve të ndryshme shoqërore. Andaj, identiteti nacional është pjesë e identitetit shoqëror në tërësi, kështu vetvetiu duket se ky identitet bazohet në përkatësinë e grupit, në këtë rast edhe të kombit. Vetëm duke qenë anëtar i grupit (kombit) individi mund të zhvillojë ndjenjat e përkatësisë nacionale. Pjesëmarrës në një grup të tillë kur të jetë, njeriu i rritet vetëbesimi, ndjenja e sigurisë, identiteti social, i njeh më mirë vlerat e veta. Por, përkatësia një identiteti nacional sipas kësaj teorie mund të sjellë edhe probleme, ngase individi duke qenë pjesëtar i një grupi të pazhvilluar etj., mund t'i kthehet me efekte negative ky nivel përkatësie, në formën më të shprehur si humbje e vetëbesimit, humbje e ndjenjës për vlerat e veta etj. Duhet pasur parasysh se krizat e kombeve përcillen edhe me kriza identiteti përkatësie. Madje duket ekstrem, por mendimi Altaras nuk mund të mënjanohet plotësisht. Ai vlerëson se identitetin e kanë ritheksuar pikërisht dhuna, krimet dhe luftërat.⁵

Një vlerësim i tillë i referohet rënies së sistemeve autoritare në Evropën Juglindore. Vitet '90-të të shekullit të kaluar, kur ndodhi shkatërrimi i sistemeve në shtetet komuniste, kishte një ikje publike shumë të shprehur nga identitetet nacionale për të kërkuar forma tjera të identiteteve publike. Kjo është shprehur shumë edhe tek shqiptarët e Shqipërisë, që mund të shpjegohet me teorinë sociale, më saktësisht si ikje nga të qenit anëtar i një grupi social të dobët dhe në krizë, të një kombi të vogël. Jo pak të rinj shqiptarë kërkuan identitet ekzistencial, pra social, pastaj edhe religjioz dhe kulturor, duke u konvertuar në grekë apo duke kërkuar një identitet shtetëror perëndimor. Kjo ndodhi edhe nga dhuna e tërthortë në një masë, po edhe për të fituar një status social të ri, për të harruar përkatësinë identitare

⁵ Ivor Altaras Penda, "O identitetu kao osobno pitanje", *Sociologija*, vol XXXVI, nr. 1-2, Zagreb, 2006.

ideologjike dhe sociale të mëhershme që ishte varfëri dhe pa perspektivë të qartë individuale dhe kolektive.

Kështu, përkatësia grupit të fuqishëm e bënë edhe individin më të fuqishëm, me hapësira shumë më të gjera. Nëse një njeri i përket një grupi të fuqishëm, në këtë rast një grupi nacional, fjala vjen një britanik dhe amerikan, atëherë ai do ta ketë më lehtë në aspektin e realizimit të shumë kërkesave për jetë dhe punë, do të jetë më i respektuar dhe më i mbrojtur kudo që do të jetë, dhe e kundërta, një njeri që i përket një grupi nacional të pazhvilluar dhe të varfër, do të ketë shumë më vështirë, mbasi jo rrallë do të akuzohet dhe identifikohet si problem edhe pa qenë fare i tillë. Pyetja më e thjeshtë do të jetë, mbështetur në përkatësinë e grupeve sociale, nëse janë të barabartë pjesëtarët e kombeve të vogla me ata të kombeve të mëdha, nëse nisemi nga fakti se edhe kombet janë grupe sociale të forcës, diktuar nga numri dhe dinamikat e ndryshme? Natyrisht, nuk mund të injorohet argumenti i teorisë sociale që përfaqësohet nga këta autorë. Pra, fjala është për diferencat sociale në kontekstin e përkatësisë së grupit social të fuqisë apo të pafuqisë së tyre.

Po, në këtë kontekst, së pari, cila ishte qasja dominuese në interpretimin studimeve shqiptare për diferencat dhe ngjashmëritë? Duke pasur parasysh praktikën sociale dhe politike shqiptare, nuk mund të bëhet fjalë për një koncept të lirë shkencor sociologjik, politikologjik, filozofik etj., të trajtimit të identitetit as në Shqipëri dhe as në Kosovë. Në shkencën shqiptare, qoftë kulturologjike qoftë sociale, kjo temë u hap bujshëm në vitet '20-të të shekullit XX, dhe në mënyrë sporadike, u sistemua me modelin referues sociologjik-filozofik me emrin Neoshqiptarizma, për t'u mbyllur shumë shpejt, përfundimisht në vitet '40, mbasi u dënuan dhe u mënjanuan pothuajse të gjithë bartësit e ideve kritike për identitetin shqiptar qoftë fizikisht qoftë veprat e tyre si, Konica, Frashëri, Merxhani, Cika etj. Mbas kësaj ndërhyrjeje me revolucion ideologjik zotëron periudha e qasjes pseudo-kulturore që i bëhet identitetit shqiptar duke e paraqitur kryesisht atë si antipod kulturor përëndimor dhe koncept ideologjik. Të menduarit dhe të gjykuarit emocional e etnofolklorik, në njërin anë, dhe ideologjik-klasor, në anën tjetër, nuk mundësuam dhënien e një përgjigjeje të plotë për modelin dhe vlerat e këtij

identiteti. Praktikisht, nuk u krye përkufizimi i vlerave primare dhe as sekondare të identitetit shqiptar, që ishte qëllimi kryesor i këtyre intelektualëve, kryesisht kulturologë.

Mbeti e hapur pyetja që e kishte shtruar në revistën e famshme "Hylli i Dritës", që në vitin 1937, Krist Maloki, përmes shkrimit pamflet politik-filozofik, me titull: Oriental apo Okcidental? ⁶

Ku ishte dhe çfarë paraqiste identiteti shqiptar? Nga qasja mbi katërdhjetëvjeçare, e sipërfaqshme, ka mbetur sa lexohet apo përmendet fjala - identitet, të veprojë konotacioni i saj si një persistencë psikologjike, mbasi kuptimi është për identitetin nacional, përkatësisht, përkatësinë etnike, dhe ndjenjën e alarmuar dhe gjykimin reduktues, të sintetizuar në pohimin: Unë jam Ne. Madje, Ne, prore e shkruar domosdoshëm që, në shkronjën e pare, me të madhe. Nga këndvështrimi reduktues, duket sikur i përmbledh ky nocion të gjitha dhe nuk ka asnjë lloj mundësie, madje as nevoje, të shkohet tutje, pra përtej identitetit kolektiv. Ne jemi vetëm Ne! Këtu kemi të bëjmë pikërisht me konceptin e Pendas se tërësia e elementeve që anëtarët e ndonjë grupi social pranojnë si shenja të tyre; ata me këtë njohin vetveten si pjesëtarë të një grupi më të gjerë dhe më këtë edhe dallojnë prej grupeve e tjera sociale. ⁷

Po cili është ky identitet kaq preokupues në tërë shek. XX dhe që vazhdon të jetë po kaq preokupues edhe në shek. XXI? Një përkufizim më i pranuar për identitetin nacional do të thoshte se ai përcakton tërësi të elementëve që ndërliken me prejardhjen etnike, gjuhësore, kulturore tradicionale, zakone e norma zakonore, kushte të jetës, po edhe kulturë moderne, gjendje shoqërore. Pra, pikërisht piketohet fjala etnike në kontekstin vetidentifikues dhe identifikues A=A. Në këtë kontekst madje, qasja kryesor është ajo mbi konceptin etnik dhe të tjerët pak a shumë derivohen nga kjo primarësi përkatësie, dhe madje, të menduarit jo kritik, është interpretuar edhe si prejardhje historike, apo edhe si prejardhje e individuale-kolektive si: traditë fisnike, rrënjë e gjakut. Por, nuk është fjala

⁶ Shih: Krist Maloki: *Oriental apo Okcidental*, Plejada, Tiranë, 2003, f.106-122.

⁷ Ivor Altaras Penda, vep. cit.

vetëm për standardin e të menduarit, por edhe të të komunikuarit. Identiteti, çdo lloj identiteti, do pasur parasysh pa mundësinë e injorimit, ka edhe aspektin komunikues që e shtron Llotman në librin *Kultura e bumit*. Ai vë re se tradita na ka ngulur në tru mendimin që drejtimi i vetëdijes njerëzore është i orientuar nga individualja (e vetmja) për tek e përgjithshmja. Nëse me individuale nënkuptojmë aftësinë për të shumëzuar numrin e dallimeve, për të gjetur në po të njëjtën gjë të ndryshmen, atëherë kjo, sigurisht, është njëra nga marrëdhëniet kryesore të progresit kulturor. Duhet vlerësuar, që aftësia për të dalluar të ndryshmen në njëjtësinë dhe njëjtësinë në të ndryshmen, janë dy anë të pandara nga njëra-tjetra të një procesi të vetëm të vetëdijes. Padallueshmëria e të ndryshmes nuk e thekson, por e shkatërron ngjashmërinë, sepse e likuidon për fare krahasimin (pranëvënien).⁸

Dallueshmëria dhe mosndryshimi? Është ky një kuptim dhe domethënie edhe në kulturat e tjera, i cili sforcohet duke përdorur në formën e dallimeve pragmatike edhe nocionin - etnike. Madje ende më shpesh se sa etnike, bie të dëgjohet nocioni grupi etnik, i cili në anglishte - ethnic group,- në shqipe ka domethënien e një bashkësie entike, - bashkësi e njerëzve që kanë identitet të përbashkët në themele të njëjta të kulturës, traditës, religjionit, historisë, gjuhës, prejardhjes etnike dhe veçorive të tjera. Etnia, në frëngjishte - ethnies, në italisht - etnia, të dy kanë një kuptim të përafërt me atë në anglishte.⁹

Duket si një proces i natyrshëm se vetëdija etnike është sistem vlerash të lidhura me një kontinuitet historik komunikues. Por, siç dëshmon praktika sociale, në një makroetni janë shumë të shprehura sub-etnitë (bashkësi jo të tërësishme), por që nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, në një formë, madje, mbajnë të gjalla shumë nga diferencat.

⁸ Jurij Llotman, vep. cit. f. 22.

⁹ Identiteti etnik nuk identifikohet me identitetin nacional, megjithëse ka pikëtakime të shumta me të. Identiteti nacional, ang.. ethnic identity, është një koncept sociologjik-politik që më së pari është zhvilluar në shkencën angloamerikane. Me këtë nocion theksohet prejardhja e përbashkët historike dhe kulturore e një bashkësie.

Pra, duke i mbetur besnik kësaj qasjeje, identiteti shqiptar kolektiv kohë të gjatë ka mundur të gjykohej që ka afërsi me shkrirjen në bërthamën sociale - familje, gjini, fis,¹⁰ popull dhe së fundi komb. Hetohet se është një lloj i identitetit grupor dhe identifikohet si identitet social, një kategori kognitive-intelektuale-emocionale kolektive. Në kuptimin modern, identiteti ka edhe disa përbërës dallues, të cilët ende nuk janë plotësisht të shprehur në shoqëritë apo rajonet më pak të zhvilluara. Gilroy thekson se ne jemi të informuar vazhdimisht se ndarja e identitetit është dallimi më themelor i nivelit kombëtar, "racial", etnik, rajonal dhe lokal. Identiteti gjithherë është dallues dhe i veçantë. Ai shënon ndarjen në nivelin tonë social dhe ndihmon në përkufizimin e kufijve mes ndryshimeve, përpjekjeve lokale që të kenë kuptim në botë. Socialiteti mund të shprehet edhe në kontekstin e përkufizimit të Pendas, si tërësia e elementeve që anëtarët e ndonjë grupi social pranojnë si shenja të tyre; ata me këtë njohin vetveten si pjesëtarë të një grupi më të gjerë dhe më këtë edhe dallojnë prej grupeve të tjera sociale.¹¹

Në anën tjetër, pakkush flet më për identitetin njerëzor. Koncepti, në anën tjetër, sipas Gilroy, orienton të menduarit nga çdo ndërhyrje me ngjashmëritë themelore dhe antropologjike. Siç e vënë në refleksion e të menduarit në konceptin: "duket sikur ne presim që nga termi identitet do të ketë specifikimin kultural dhe në raste të caktuara ne edhe mund të presim që identiteti dhe specifikimi për të bashkërenduar pandryshueshëm".¹²

Në këtë kontekst, sipas këtij autori, identitetit mund t'i gjendet përgjigja në pyetje e fuqisë dhe të autoritetit, kur grupi kërkon për të shprehur realizimin e tij politik. Kjo mund të jetë në frymën: kombësia, shteti, një lëvizje, një klasë, ose ndonjë kombinim i paqëndrueshëm.¹³

¹⁰ " Kush nuk njih fisin e vet, ai ndo ash i anas a nip bije, ndo theas (i huaj-vër. jonë) e atëherë s'asht Shqyptar". Kështu thotë "Kanuni i malevet", in "Bota Shqiptare", 1943, f. 66.

¹¹ Ivor Altaras Penda, vep. cit.

¹² Paul Gilroy: *Against race*. HUP, Massachusetts, 2000, f. 99.

¹³ Po aty.

Qasja kulturologjike për identitetin është e ndryshme nga ajo sociale. Një kësi përkufizimi teorik për identitetin e paraqet edhe Malinson, duke ua shtuar këtyre faktorëve fikSIONIN mendor, i cili garanton qëllime dhe veprime të përbashkëta për tërë një grup, të gjitha këto të ndërlidhura me traditë nacionale të arsimimit. Krahas këtij përkufizimi të Malinsonit, do të ishte me interes të nënvizohet posaçërisht një përkufizim që natyrisht është, vetëm njëri nga shumë, me preferencë qasjeje psiko-sociologjike, dhënë nga Bayat. Ai hedh tezën se çdo komb është i konstituuar nën ndikimin e disa elementëve qenësorë subjektivë dhe, mbi të gjitha, nga emotiviteti njerëzor. Identiteti, sipas këtij teoricieni, është i lidhur shumë me vetëdijen nacionale, e cila shtrin refleksione edhe në ndjenjat e veçanta, madje edhe në format e ndryshme të nacionalizmave, pastaj në manifestimet shpirtërore, mitike, religjioze, të traditës dhe të kulturës stërgjyshore. Të gjitha këto janë elemente subjektive sa do që pretendohet të transferohen edhe reflektojnë ndikim edhe në hapësira objektive.

Nëse i referohemi historisë së Ballkanit, atëherë do pranuar, se modeli identifikues etnokulturor u dominua nga krenaria dhe madhështia për vete, nga vetëdija kolektive dhe mobilizimi nënçmues për tjetrin, dhe një pozicionimi ekstrem i barrikaduar në mitomani, ideologji, stereotipe - paragjykime. Megjithëse shpesh nuk pranohet me ëndje, nga pozita e të vlerësuarit kritik, ky model identiteti mbetet në suazat e sentimenteve, duke pasur si forma shprehëse kryesore nacionalpatriotizmin dhe romantizmin. Modeli i tillë tipik i kësaj fryme në Ballkan është ai i të filozofuarit nacional serb, i cili identitetin e kërkon në mitet dhe referencat që kanë të bëjnë me shkatërrimet e popujve të tjerë, duke provuar të paraqiturit superior dhe me të drejtën historike për të mbërritur këto, nëse është e nevojshme, madje edhe në veprime dhune dhe krimi shtetëror. Pse ndodh një urrejtje dhe armiqësi kaq e madhe mes popujve që jetojnë gjatë në një hapësirë të ngushtë fizike, sociale dhe kulturore, kur pikëtakimet mund të jenë më të mëdha se sa dallimet? Ka pasur studiues siç është Gilory që provon të gjejë burimin e saj. Ai mendon se njerëzit e ndryshëm vërtet urrehen dhe frikësohen, por me kohë antipatia kundër tyre nuk paraqet asgjë fare përballë urrejtjes që bëhet ndaj atyre me gjysmë

dallimi apo dallim të pjesshëm. Të kesh identitet të përzier do të thotë të jesh pjesë e tradhtisë së madhe. Secila çështje e padefinuar e hibridizimit duhet në mënyrë të tërthortë të hiqet nga ngushtësia që zbehet jashtë zonës së një kulture pamundësisht të pastër.¹⁴ Në anën tjetër, gjuha politike mbetet e tensionuar dhe burim i konfliktit, mbasi gjuha politike e nivelit të identitetit dallon në veçanti në mes të lidhjes së zgjedhur dhe të veçantës së dhënë: në mes të personit të cilin e keni zgjedhur ju që të jeni, dhe gjërave që e përcaktojnë identitetin tuaj, që është synimi i juaj.¹⁵

Natyrisht, qasjet e veçanta, të shumtën nuk përmbledhin gjithë kompleksivitetin e kësaj teme, e cila siç është vërejtur, veçmas nga trajtimet publicistike shqiptare, që e shtrojnë sipërfaqshëm, jo rrallë edhe me fatalitet dhe dramë. Këto janë qasje që nuk e ndihmojnë ndriçimin e plotë të errësirës së identitetit apo edhe të identiteteve, të cilat si kudo, edhe në Ballkan, janë të ndërthurura dhe jo rrallë, kanë një burim të konflikteve afatgjate që nis nga primesa se gjithçka brenda vetes është në rregull, por problemet vijnë nga jashtë, nga të tjerët. Ne jemi të mirë, por Ata janë të këqij. Këtë dobësi e kishte theksuar në mënyrë shumë të drejtpërdrejtë dhe të plotë intelektual shqiptar Kostë Chekrezi. Ky gjykim nuk është përkues me gjykimin folklorik dhe të ndërtuar gjatë nga pseudoshkenca shqiptare mbi të keqen e përhershme që erdhi nga politika e shteteve të fuqishme dhe që e trajton Kostë Chekrezi në studimet e tij. A mendon se “Shqiptarët e kanë zakon - edhe ky asht një faktor psikologjik - që të mallkojnë Fuqitë e Mëdha për intrigat dhe pabesitë e tyre, dhe të çthuren në sharje kundër fqinjëve të tyre të ‘panginjur’ dhe ‘gjakpirës’, sepse këta janë munduar të çdukin racën arbnore me planet e tyre ‘satanike’. Po shqiptarët harrojnë se çdo komb e ka brenda në trupin e tij krymbin e lengimit dhe të vdirjes së vet. Prandaj, ndofta nuk u pëlqen të shkojnë në mendje faktin se ata vetë ose udhheqsat e tyre u japin shkak të huajve dhe fqinjëvet që të përfitojnë nga grindjet dhe mosmarrëveshjet e një kombi të përçarë”.

¹⁴ Po aty, f. 106.

¹⁵ Po aty.

Pra, çështja e identiteti shtrohet dhe duhet parë më shumë brenda vetes. Cili është subjekti i vërtetë? Cili është raporti ndërmjet subjektit dhe objektit? Kritikuesit e konceptit të Bayas shtrojnë pyetjen: si mund të matet saktësisht përmasa e vetëdijes njerëzore dhe emotiviteti në periudha të hershme, pra në një të kaluar të errët dhe enigmatike? Në këtë rast, nuk është e mundur të jetë e duhur masa kritike e qasjes, dhe për këtë arsye identiteti i venë në një kornizë historike, është të shumtën emotiv, irracional dhe konfrontues. Se është kështu komplekse tema, tregojnë edhe zbulimet e vazhdueshme arkeologjike, nga të cilat hetohen dallime të shumta në secilën hapësirë të shprehur me pluralitet kulturash materiale dhe shpirtërore.

Do pranuar se një hulumtim më serioz, të ndalë në përfundimin se identiteti shqiptar në kontekstin e përkatësisë evropiane edhe përfundimore në tërësi, nuk është studiuar dhe ka mbetur larg hulumtimeve interdisiplinare. Identiteti nuk është e mundur të studiohet nga një kënd disiplinuar, siç ka ndodhur kryesisht, pra as vetëm nga këndi gjuhësor-linguistik, historiografik, etnologjik, politikologjik, gjeografik, filozofik, kulturor, sociologjik etj..

T'i kthehemi edhe një herë qasjes dominuese në sqarimin e identitetit shqiptar, që ishte pra historiografike - ideologjike, linguistike dhe letrare-publicistike. Nuk ka prodhuar kjo qasje ndonjë të veçantë shkencore. Duke mos qenë as gazetari dhe as shkencë, trajtimet, debatet, polemikat, kryesisht mbeten pezull, duke prodhuar motiv hutues për identitetin, ajo që njihet te latinët si përsëritje e të njëjtës, apo përsëritje e së diturës.

Identifikimi i identitetit me kombin, përkatësisht pozitën e kombit shqiptar, është primesa kryesore metodologjike e trajtimit publicistik-letrar që është forma më e shprehur. Kjo ka bërë që trajtimi herëve kryesisht kulturor-politik, të ketë në radhë të parë mesazhin emocional, si mbartje historie dhe madhështi e identitetit folklorizues. Smith e vlerësonte këtë si emocion për të zgjedhur - historinë e përbashkët.

Nuk është e rastësishme kjo qasje. Shteti i munguar ishte preokupimi kryesor i shqiptarëve dhe dominues për këtë

arsye ishte modeli entik mbasi ky model është i pranishëm aty ku kombi është afirmuar para shtetit.¹⁶

Pastaj, duke pasur referencë kombet, madje kombet-shtet si ideal, që korrespondon edhe me një periudhë të qenësishme të prosperiteti social dhe ekonomik dhe të modernitetit, qasjet nuk kanë mbërritur të shmangin interpretimin emocional. Mbasi, do pasur parasysh, se periudha e krijimit të kombeve është e ndërlidhur edhe me procese të mëdha konverguese. Kjo ishte frika nëse do të ndodhte konvergimi apo procesi do të shkonte drejt shthurjes së plotë. Në përvojat e suksesshme pikëtakoheshin tek e para. Nuk duhet injoruar faktin se në këtë periudhë, bashkohen rajonet e një populli, gjuha nacionale standardizohet, bëhet arsimit dhe kultura nacionale, tregu zgjerohet, sistemi financiar funksionalizohet, racionalizohen potencialet dhe vlerat e shpërndara, thënë me një fjalë, krijohen institucione moderne nacionale sociale, ekonomike etj. Kjo nuk është vetëm një periudhë historike që krijon frymën e nacionalizimit evropian si një shtytës edhe i zhvillimit social dhe ekonomik. Siç shprehet McNeill në librin *-Polyethnicity... Triumfi i nacionalizmit është storie e njohur. Shumë qartë u demonstrua fuqia eprore e shtetit-komb të lirë, të barabartë dhe vëllazëror francez.*¹⁷

Po iu referuam më tej këtij autori, do të mund të theksonim se baraspesha e veçantë midis homogenitetit dhe diversitetit që pak kombe perëndimore evropiane ishin në gjendje ta krijojnë në fund të shekullit 18-të dhe që e mbajtën deri në shekullin 20-të, ishte një fazë kaluese. Por, ky autor thekson se nuk u mbërriti të krijohet deri sot një identitet evropian. Komb-shteti evropian i centralizuar etnikisht nuk ka ekzistuar asnjëherë përpos si ideal. Që nga luftërat botërore të këtij shekulli thjeshtë ky synim ka dalë nga përdorimi. Nuk mund të merret si model i zbatueshëm as tashmë. Pra, etniciteti në një formë apo tjetër preferohet, mbasi lënë mënjanë gjithë disavantazhet dhe vështirësitë që ka.¹⁸

¹⁶ Paul Garde: "Dykuptimësitë e kombit dhe si mënjanohen ato", in *Identiteti evropian i Kosovës*, Forumi 2015, Prishtinë, 2007.

¹⁷ William H. McNell, vep. cit. f. 34.

¹⁸ Po aty, f. 84.

Kështu, në kontekstin tonë, pjesa dërmuese e shqiptarëve, duke qenë të robëruar, këto vlera të kombeve dhe as të një identiteti evropian, nuk kanë mund t'i kishin të plota apo edhe herë-herë i kishin plotësisht të mohuara. Sub-etnitë zotërojnë makroetninë dhe duke qenë shpesh pozitat e shkruesve mbështetur në përkatësi subkulturore, dilemat për identitetin kanë dalë më të mëdha se sa janë dhe ndërkohë edhe trajtimi për to, shumë më i ngushtë. Nuk mund të përjashtohet as fakti se, po kështu, identiteti makro dhe sub-identitetet janë në një proces të përhershëm ndryshimi, dhe shkruesit duke qenë konservatorë dhe pa shkathtësinë e përcjelljes së këtyre ndryshimeve, mbrojnë pozitat tradicionaliste, që nuk përkrijnë me qasjen kritike për identitetin në shoqërinë moderne. Fjala vjen, nëse nuk ka një shqiptar plisin, nuk do të thotë se ai ka humbur identitetin sikur që edhe nëse nuk flet gjuhën standarde, po njërën nga të folmet lokale, kombi është në udhën e mbarimit. Identitetin makroetnik shqiptar do pranuar në gjithë larushinë dhe pluralitetin kulturor, fetar, social etj., ndryshe ai nuk do të jetë fare identitet nacional. Në fund të fundit, edhe brenda një njeriu, personi, individumi, ndërthuren shumë identitete.

Nëse do të kërkoreshin shkaqet e mundshme që ndikuan në paraqitjen e subkulturave në fazë të caktuara, arsye do parë kryesisht në pozitën e shqiptarëve, përkatësisht në raportin e pakicës serbe si kolonizuese dhe të shumicës shqiptare si e kolonizuar. Nga ky raport është prodhuar edhe kompleksiviteti kulturor, etnik, politik, ekonomik dhe ai ndërveprim specifik social. Pra, raporti ishte kompleks për arsye se serbët paraqisnin një grup etnik, bashkësi etnike vendimmarrëse dhe dominuese, megjithëse pakicë ekstreme, në hapësirën makro-etnike të shqiptarëve që ishte shumicë dërmuese. Ndërkohë pozita e tyre e privilegjuar ka bërë që ata në fakt, nga kjo pozitë të kenë forcën e ndikimit makro-etnik, shtetëror. Edhe para këtij pushtimi duhet renditur synimet afatgjata paraotoman, romak, bizantin, bullgar etj., me pasojat e shumta që kanë lënë mbas secili prej këtyre pushtuesve. Madje këto okupime afatgjate, do parafrazuar Hibertin, siç ishte rasti i lidhjes së gjatë me Bizantin, i la shqiptarët pa identitet politik. Nëse deri tani kryesisht, përqendrimi i trajtimit mund të japë disa elementë të

krizës së shoqërisë shqiptare, dhe të kombit shqiptar, për arsye të pozitës socio-politike komplekse, kjo kryesisht ka ndikuar edhe në vrojtimin e këtij fenomeni si krizë të identitetit.

Nëse një individ në një kolektivitet me identitetin e tij të parë apo të dytë jeton në një klimë shoqërore të krizës (sociale, kulturore etj.), atëherë a mund të bëhet fjalë për një krizë të identitetit? Dhe, e kundërta. Ta zëmë, a ndikon gjendja psikologjike e individit dhe e kolektivitetit në kontekstin e shprehjes së individualitetit dhe në këtë kontekst edhe të identitetit nacional. A mund të shprehet identiteti në krizë në formë racionale, reale? Disa faktorë determinantë janë universalë. Ka pengesa civilizuese që shprehen në krijimin e identiteteve si pasojë e krizës së shoqërisë moderne, që është në fakt krizë e identitetit të njeriut bashkëkohor. Nuk duhet nënçmuar as kriza e identitetit individual. Duke pasur një gjendje krize personale, sipas Bauman, individi do të zëvendësojë identitetin personal me identitetin nacional. Po kështu, është shumë i njohur koncepti i tij pragmatik se “kombi krijon follenë për të humburit dhe konfuzët”. A është identiteti shqiptar identitet i krizës, ndikuar nga ndryshimet e shumta civilizuese që kanë ndodhur brenda tij në shekullin XX. Për këtë pikëpamje mund të ketë një pajtim relativ. Mund të pajtohemi edhe me vlerësimin e Mandalës, kur i qaset krizës së identitetit shqiptar, se - në përgjithësi momenti i krizës përkon me vështirësitë për të kryer tranzicionin mes një etape historike që duhet braktisur përfundimisht dhe një tjetre së cilës duam t'i qasemi, por që na tremb me të papriturat e të panjohurat e saj.¹⁹

Thjeshtësuar, kriza nga okupimi i gjatë dhe standardi i ulët kulturor dhe arsimor i shqiptarëve dalë nga ky pushtim, ka bërë që edhe pavarësia të jetë e brishtë, po edhe krijimi i identitetit nacional-shtetëror, me vlera jo përherë të qëndrueshme dhe primare.

Në periudhën e sundimit të Mbretit Zog kishte shumë konflikte dhe ndodhën edhe gjakderdhje si pretendime legaliteti dhe jo legaliteti politik, siç ishte ai i Qershorit 1924, kur ra edhe tërë pushteti përmes dhunës popullore; gjatë dhe

¹⁹ Mandala: “Analiza ...”, Gazeta Shekulli, Tiranë, 18/06/2006.

mbas Luftës së Dytë Botërore shqiptarët u përfshinë nga lufta e brishtë qytetare që vazhdoi deri në vitin 1990 si luftë e klasave; më 1997 ndodhi sërish konflikti i brendshëm si pasion i egërsuar i konflikteve të thella sociale dhe stratifikimit ekstrem, si dhe i appetiteve joracionale të politikanëve. Nga këto konflikte prore ka pasur goditje në vlera të identitetit, apo vonesë të krijimit të vlerave të reja që kanë dalë nga procesi i globalizimit.

Kriza e identitetit shqiptar më shumë do parë në një faktor që rrallë është përmendur, dhe ai ka të bëjë me ndryshimet e mëdha industriale, që në fakt ndër shqiptarët nuk janë të pranishme, apo janë fare pak të pranishme deri në pjesën e dytë të shek. XX. Industrializimi ka qenë faktor kryesor i modernizimit të kombeve dhe ky shembull mund të shihet në gjithë Evropën Perëndimore, në Amerikë, Japoni etj, dhe në vende të tjera të përfshira në procesin dinamik të industrializimit. Industrializimi, si një proces i shoqërive liberale, nuk ka qenë e mundur të zbatohet plotësisht madje as në shtetin shqiptar. Kriza e sistemit totalitar, me primesa introjente, që e redukton sovranitetin nacional për të forcuar sovranitetin ideologjik, ishte një faktor i reduktimit të nivelit dhe shkaktar i krizës së identiteti. Nuk duhet lënë mënjanë faktin se edhe kombi shqiptar është ai i procesit të ndërthurjeve të brendshme politike, sociale, ndonjëherë edhe fetare.

Megjithëkëtë pozitë specifike, nuk vihet në dyshim fakti se kombi dhe identiteti kombëtar shqiptar në shek XX kanë pasur prirje të bëhen fenomen modern. Po në tërësinë e tij, kombi shqiptar si institucion, është paraqitur më vonë se në vendet e tjera evropiane, për arsye të okupimit të gjatë dhe vështirësive që e kanë përcjell atë në procesin e realizimit të lirisë, madje edhe mbas vitit 1912, kur bëhet pavarësia e Shqipërisë. Konstituimi i plotë ka pasuar ngecjen në periudhën më të rëndësishme, në tërë shek. XX, për shkakun edhe të ndarjes së kombit përgjysmë, në njërën anë dhe të organizimit të dobët institucional, të shtetit shqiptar, në anën tjetër. Edhe në Shqipërinë e paspavarësisë janë shprehur më shumë mikroidentitete, shpesh të paqarta dhe konfuze, të cilat e kanë vështirësuar konstituimin e kombit shqiptar si një fenomen modern, në kuptimin e fenomeneve të ngjashme të kombeve evropiane.

Pavarësisht nga kontekstet, identiteti shqiptar, po ndryshon dhe do të ketë ndryshime edhe më tej, posaçërisht në procesin e ristrukturimit politik, ekonomik dhe kulturor, të krijimit të një hapësire reale evropiane, pa mënjanuar edhe elemente të konvergjimit Oksidenti dhe Orienti. Jo vetëm në kuptimin fizik, por të vlerave shpirtërore, ashtu siç thotë edhe Maloki. Asht një gabim i trash kur thohet shumë herë se orientalizma na ka ardhë sefte nga Azia, apo neper religjionin muhamedan apo edhe nga populli turk. Jo, kurrsesi, orientalizma e jonë asht një dhanti-darovë fatale e kristianizmit, megjithqë e një kristianizmi euro-aziatik.²⁰

Së voni, shqetësimi i mbrojtësve të identiteteve nacionale, fokusohet në problemet që krijohen në procesin e globalizimit, i cili po kështu, mendohet se redukton disa vlera dhe faktorë të sovranitetit shtetëror-nacional po edhe të kulturës nacionale. Ndoshta do të jetë shumë më e rëndësishme të fokusohen hulumtimet edhe në burime të tjera që ndikojnë në krizën e identitetit, mosdefinimin e kthjelltë të prioriteteve politike, ekonomike dhe sociale, dhe në tjetrën, në ato që janë të lidhura me veprimin e grupeve radikale neoideologjike të majta dhe të djathta, pastaj të grupeve radikale religjioze etj.. Radikalizimi i veprimeve të këtyre grupeve do të mund të marrë shumë energji krijuese nacionale.

Qasja publicistike zotëroi në trajtimin e temës së identitetit shqiptar. Kjo qasje mbajti identitetin në një gjendje status quo-je, duke sforcuar standardin tradicional kulturor dhe social. Koncepti interpretues romantik, folklorik i kombit, provoi të intepretojë krizën e identitetit si humbje e vlerave tradicionale, siç janë familja, fisi, provincialiteti, të folmet rajonale etj., dhe jo si proces i rritjes së konvergjimit, tjetërsimit, rezignimit etj. Nuk respektohet në shkallën reale se identiteti nacional është kategori juridiko-politike dhe në anën tjetër edhe i lidhur ngushtë me ekzistimin e bashkësisë kulturore. Identiteti nacional shprehet përmes institucioneve të përbashkëta, detyrave dhe përgjegjësive të të gjithë anëtarëve të një grupi.

²⁰ Krist Maloki, vep. cit. f. 111.

Bibliografia:

- Agar, Michel: *Understanding the culture of conversation*, New York, 1993.
- Berisha, Ibrahim: *Media dhe tranzicioni*, AAB, Prishtinë, 2007.
- “Bota Shqiptare”, MA, XXI, nr. 3, Tiranë, 1943.
- Friedman, J.: *Cultural Identity and Global Process*, Sage Publications, London, 1994.
- Frashëri, Midhat: *Vepra*, Rilindja, Prishtinë, 1996.
- Frashëri, Kristo: *Identiteti kombëtar i shqiptarëve*, Tiranë, 2006.
- “Gazeta Shekulli”, Tiranë, 18/06/2006.
- Gilroy, Paul: *Against race*. HUP, Massachusetts, 2000.
- Heffery R...: *Race, Politics, and the Challenge of Urban Education*, PUP, New Jersey, 1990.
- Identiteti evropian i Kosovës*, Forumi 2015, Prishtinë, 2007.
- Kulla, Ndrichim: *Antologjia e mendimit shqiptar*, Plejada, Tiranë, 2003.
- Kullashi, Muhamedin: *Përplasja e identiteteve*, Dukagjin, 2003.
- Llotman, Jurij: *Kultura dhe bumi*, përktheu Agron Tufa. Bot. elektr. 2002.
- Maloki, Krist: *Oriental dhe okcidental*, Plejada, Tiranë, 2003.
- McNeill, William H.: *Poly-ethnicity and national unity in world history*, University of Toronto Press, 1985.
- McGuigan, J.: *Modernity and Postmodern Culture*, Open University Press, Buckingham, Philadelphia, 1999.
- Sociologjia*, vol XXXVI, nr. 1-2, Zagreb, 2006.